



**APLIKIM PËR KARTË DEBITI
-PËR KLIENT BIZNESI-
APPLICATION FOR DEBIT CARD
-FOR BUSINESS CLIENTS-**

1. TË DHËNAT E OFRUESIT TË SHËRBIMIT/ISSUER DATA

ProCredit Bank sh.a person juridik i regjistruar në Qendrën Kombetare të Biznesit me nr. Unik identifikimi (NUIS) J91524011J, në datë 11.02.1999, me seli Rruga Dritan Hoxha, Laprakë, Tiranë.

ProCredit Bank sh.a, a legal entity registered in National Business Center with a unique identification number J91524011J, on 11.02.1999, with main office in Dritan Hoxha Street, Tirana

Dhe/And

2. TË DHËNAT E PËRFITUESIT TË SHËRBIMIT/BENEFICIARY DATA

Emri i Kompanisë/ Company Name

NUIS / Unique Identification number

Emri, Atësia, Mbiemër/Name, Paternity, Surname

Ditelindja / Date of Birth

Nr. i Identitetit/ ID number

Adresë Email/Email address

Nr. I Celularit / Cell phone number

3. KËRKOJ TË APLIKOJ PËR KARTË DEBITI¹: / I REQUEST TO APPLY FOR A DEBIT CARD:

Statusi i mbajtësit të llogarisë/Cardholder Account Status:

Përfaqësues Ligjor / Legal Representative

Person i Autorizuar²/ Authorized Person

Numri i llogarisë kryesore që do të lidhet me kartën

The main account number to be associated with the card

_____ - _____ - _____

¹ Për kartë debiti të tretë aplikohen komisionet sipas listës së cmimeve në fuqi/For the third debit card, will be applied the commissions according to the price list in force

² Vetëm Person i Autorizuar me nivel A në llogari mund të aplikojë për kartë /Only Authorized Person with level A in the account can apply for a card

**Deklarata e klientit:**

1. Nëpërmjet këtij formulari Aplikoj(më) për të lidhur një marrëveshje biznesi për t'u pajisur më një kartë debiti. Pranoj që kartën e debitit ta marr në dorëzim nëpërmjet shërbimit postar në adresën e deklaruar pranë bankës. Autorizoj(më) ProCredit Bank sh.a që të kryejë aktivizimin e këtij produkti sipas të dhënave të reja të deklaruar në këtë formular.

2. Deklaroj që nënshkrimi i depozituar (emer, mbiemër, firmë) është autentike dhe më përfaqëson në veprimet me Bankën ProCredit . Konfirmoj se informacioni i regjistruar është i vërtetë, korrekt dhe i plotë.

3. Konfirmoj që kam lexuar dhe marrë parasysh dokumentet në vijim dhe se jam dakord. Kam shkarkuar këto dokumente dhe i kam ruajtur dhe / ose shtypur ato në mënyrë që të jenë në dispozicion për mua përgjithmonë: [Termat dhe kushtet](#) dhe [listën e cmimeve](#) si dhe pasqyrën e shërbimeve të ProCredit Bank.

4. Autorizoj bankën ProCredit Bank sh.a. që të kryejë ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të regjistruara nëpërmjet këtij formulari. Jap pëlqimin tim që Banka të përpunojë të dhënat personale, si dhe informacionin financiar mbi mua përgjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies me Bankën, në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe Udhëzimin Nr. 20, datë 03.08.2012 "Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar". Gjithashtu, deklaroj se jam në dijeni që të dhënat e regjistruara në këtë formular për arsye efiente dhe cilësie të lartë shërbimi mund të transferohen dhe disa shërbime mund të kryhen në kohë reale nga Banka ProCredit në Kosovë dhe nga kompania QUIPU GmbH në Gjermani (i cili është vend me nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje për të dhënat personale). Për realizimin e shërbimeve të ofruara nga banka kundrejt Klientit nevojitet që të dhënat e tij personale të transferohen në kuptim të ligjit në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale" pranë Bankës ProCredit në Kosovë, shtet i cili nuk ka nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë arsye transferimi do të kryhet në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar si dhe Udhëzimin Nr. 41, Datë 13. 06. 2014 "Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave", duke synuar sigurimin e një niveli të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Përsa më sipër, jap pëlqimin tim dhe shpreh vullnetin tim të plotë dhe të lirë për kontrollin, përpunimin dhe transferimin e të dhënave të mia personale që janë dhënë në këtë formular drejt këtyre shteteve, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies kontraktore midis meje dhe ProCredit Bank sh.a. Të dhënat personale apo financiare të Klientit, të mbledhura nga Banka, do të kontrollohen, përpunohen, transferohen për qellim të zbatimit dhe mbarëvajtjes së të gjithë marrëdhënies kontraktore midis Klientit dhe Bankës dhe do të ruhen në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe Udhëzimin Nr. 20, datë 03.08.2012 "Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar".

Pranoj që te informohem me me SMS/Tel/ e-mail rreth shërbimeve bankare dhe ProCredit Bank sh.a. Unë mund ta ndërpres komunikimin me SMS/Tel/e-mail në çdo kohë, përmes ueb faqes. Gjithashtu autorizoj ProCredit Bank që të ruaj dhe përpunojë të dhënat e mia personale në përputhje me legjislacionin.

Shpreh interesin për të aplikuar pranë ProCredit Bank sh.a produktin e zgjedhur më sipër. Banka ka të drejtë që të zhvillojë hapat e mëtejshme të këtij aplikimi pasi të kryejë vlerësimin e situatës time ekonomiko-financiare dhe të dhënave të mia si dhe pasi të nënshkruhen të gjitha dokumentat e nevojshme për këtë qëllim. Ky është vetëm një aplikim fillestar për të marrë këtë produkt pranë bankës dhe nuk konsiderohet si momenti zyrtar i celjes së aplikimit për këtë produkt. Unë e kuptoj dhe jam dakord që aplikimi për këtë produkt do të konsiderohet i filluar zyrtarisht vetëm pas nënshkrimit të dokumentacionit të nevojshëm të përmendur tek rregulloret në fuqi të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu kuptoj dhe jam dakord që ky produkt do të konsiderohet i celur menjëherë pas nënshkrimit të kontratës përkatëse nga përfaqësuesit e bankës dhe nga unë Banka do të mbylli përfundimisht këto produkte nëse unë nuk paraqitem pranë bankës për të nënshkruar kontratat përkatëse dhe për të kryer aktivizimin e tyre brenda afatit 10 ditë pune nga kërkesa e saj

Declaration of the client:

1. Through this form I apply to enter into a business agreement to be provided with a debit card. I agree to receive my debit card through the postal service at the address stated at the bank. I authorize ProCredit Bank sh.a to activate these product according to the new data declared in this form.

2. I declare that the deposited signature (name, surname, and signature) is authentic and represents me in transactions with ProCredit Bank.

3. I confirm that I have read and considered the following documents and that I agree. I have downloaded these documents and saved and / or printed them so that they will be available to me forever: [Terms and conditions](#) and [price list](#) as well as the overview of ProCredit Bank services

4. I authorize ProCredit Bank sh.a to perform the storage and processing of data recorded through this form. I confirm that the recorded information is true, correct and complete. I give my consent for the Bank to process personal data, as well as financial information about me during the duration of the relationship with the Bank, in accordance with Law no. 9887, dated 10.03.2008, "On the protection of personal data", as amended, as well as Instruction no. 20, dated 03.08.2012 "On the processing of personal data in the banking sector". I also declare that I am aware that the data recorded in this form, for reasons of efficiency and high quality of service, can be transferred and some services can be performed in real time by ProCredit Bank in Kosovo and by the company QUIPU GmbH in Germany (which is a place with a sufficient level of protection for personal data).

For the realization of services provided by the bank to the Client it is necessary that his personal data be transferred within the meaning of the law in force "On personal data protection" at ProCredit Bank in Kosovo, a country which does not have a sufficient level for the protection of personal data. For this reason, the transfer will be carried out in accordance with Law no. 9887, dated 10.3.2008 "On the protection of Personal Data", as amended and Instruction no. 41, Date 13. 06. 2014 "On permitting certain categories of international transfers of personal data in a country that does not have a sufficient level of data protection", aiming to ensure a sufficient level of data protection.

As mentioned above, I give my consent and express my full and free will to control, process and transfer my personal data provided in this form to these countries, throughout the duration of the contractual relationship between me and ProCredit Bank sh.a.

The personal or financial data of the Client, collected by the Bank, will be checked, processed, transferred for the purpose of implementation and smooth running of the entire contractual relationship between the Client and the Bank and will be stored in accordance with Law no. 9887, dated 10.03.2008 "On the protection of personal data", as well as Instruction no. 20, dated 03.08.2012 "On the processing of personal data in the banking sector".

I agree to be informed by SMS / Tel / e-mail about banking services and ProCredit Bank sh.a. I can interrupt communication by SMS / Tel / e-mail at any time, through the website. I also authorize ProCredit Bank to store and process my personal data in accordance with the legislation of the field throughout the duration of the relationship with the Bank for banking services and for promotional purposes.

I express interest in applying to ProCredit Bank for the product selected above. The Bank has the right to develop further steps of this application after conducting an assessment of my economic and financial situation and my data as well as after signing all the necessary documents for this purpose. This is only an initial application to receive this product from the bank and is not considered as the official moment of opening the application for this product. I understand and agree that the application for this product will be considered officially started only after the signing of the necessary documentation mentioned in the applicable regulations of the Bank of Albania. I also understand and agree that this product will be considered marketed immediately after the signing of the relevant contract by the bank representatives and by me the Bank will finally close these products if I do not appear before the bank to sign the relevant contracts and perform the activation of within 10 working days from its request

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PËRDORIMIN KARTËS SË DEBITIT

1. Lëshimi i kartës

1.1 Karta e Debitit është dhe mbetet Pronë e Bankës gjatë gjithë kohës. Karta e Debitit i lëshohet të gjithë personave mbi moshën 18-vjeç me vendbanim në Shqipëri, e që i përbushin kushtet e percaktuara nga vetë Banka. Banka merr vendim për lëshimin e kartes ne baze te kerkeses se aplikantit dhe merr persiper te informoje ate mbi vendimin e marrë.

1.2 Karta shtese mund të lëshohet me kërkesë të aplikantit shtese dhe per kete kërkohet miratimi i mbajtësit kryesor të kartes. Mbjatësi kryesor i kartes mban përgjegjësi për të gjitha transaksionet e kryera gjatë përdorimit të kartes shtesë. Nëse Banka e sheh te arsyeshme, ajo dhe aplikanti nënshkruajnë një marrëveshje për lëshimin e Kartes së Debitit. Kartat duhet të terhiqen personalisht nga mbajtësi i kartes.

1.3 Vetem mbajtësi i kartes ka te drejte perdorimi te kartes. Ndalohet transferimi apo perdorimi i saj nga te trete.

1.4 Afati i vlefshmerise se kartes eshte 3 vjet, nëse nuk anulohet perpara ketij afati te perfundimit te vlefshmerise nga mbajtësi i kartes apo Banka.

1.5 Ne perfundim te afatit te vlefshmerise Banka merr persiper te realizoje rinovimin automatik te kartes, kjo vetem ne rast se mbajtësi i kartes nuk ka njoftuar per mos rinovim te saj nje muaj perpara dates se perfundimit te afatit te vlefshmerise.

Me realizimin e rinovimit automatik te kartes mbajtësi duhet te marrë ne dorezim karten, sipas procedurave te bankes per realizimin e ketij sherbimi

1.6 Banka ofron ndërrimin e kodit te kartes nëse eshte e nevojshme kundrejte pageses se komisionit (nese ka)

1.7 Mbjatësi kryesor i kartes merr përsipër të paguajë detyrimet qe do te rrjedhin nga përdorimi i kartes. Mbjatësi i kartes shtese, është solidarisht përgjegjes për të gjitha shpenzimet e bëra me karten që mban emrin e tij/saj.

1.8 Mbjatësi i kartes duhet që, ne momentin e marrjes së kartes se tij/saj te nënshkruajë karten në hapësirën e caktuar. Ai/Ajo merr përsipër qe perpara realizimit te cdo transaksioni te mundshem me karten të realizoje ndryshimin e numrit personal te identifikimit (PIN kodin sekret) ne ATM me te afert te ProCredit ne Shqipëri dhe t'i ruajë karten dhe PIN kodin veçmas dhe në vende të sigurta. PIN kodi nuk duhet të shënohet në karte.

1.9 Ne rast se aplikuesi i kartes nuk ben terheqjen e saj brenda nje afati 2 mujor nga dita e lajmerimit per terheqje, Banka rezervon te drejten e mbylljes se kartes edhe pse per kete karte eshte paguar tarifa e aplikimit apo rinovimit dhe tarifa e mirmbajtjes.

2. Përdorimi i kartes

2.1 Mbjatësi i kartes mund ta përdorë karten për të blere mallra apo sherbime në të gjitha pikat e shitjes ne Shqipëri dhe jashtë saj që kanë te ekspozuar shenjën e Kartes se Debitit. Mbjatësi i kartes mund ta përdorë karten për të tërhequr të holla "CASH" në të gjitha makinat ATM dhe pikat e shitjes, ne Shqipëri dhe jashtë saj, që kanë të ekspozuar shenjën e Kartes se Debitit. Gjatë përdorimit të kartes nëpër pikat e Shitjes mbajtësi i kartes duhet ta identifikojë veten duke futur Numrin Personal të Identifikimit (PIN). Gjatë përdorimit të kartes në pikat e shitjes ku kryen blerje të mallrave apo shërbimeve dhe tërheqje të parave, mbajtësi i kartes duhet të identifikohet duke futur Numrin Personal të Identifikimit (PIN) dhe duke firmosur me firmen e tij personale fletëpagesën, me te njejten firme qe rezulton në karte, ne pjesen e prapme te saj ne hapësirën e percaktuar per firmen, si dhe mban një kopje të fletëpagesës. Çdo tërheqje e parave nëpër pikat e terheqjes "CASH" mund te kete nje tarifë për shërbim, siç përcaktohet nga Banka (shih tarifat për shërbime).

2.2 Mbjatësi i kartes i pranon të gjitha shumat debi për transaksione të kryera nepermjet kartes, pa firme por nepermjet identifikimit me CVV2 (kodi 3 shifror prapa kartes) ne rast te blerjeve nepermjet postës, transaksioneve të bëra me telefon apo përmes internetit (E- Commerce)

2.3 Përdorimi i kartes së bllokuar, të skaduar apo jo te vlefshme si dhe perdorimi i saj për qëllime të paligjshme, eshte i ndaluar dhe mund te

shkaktoje ndjekjen penale të mbajtësit të kartes. Mbjatësi i kartes mban përgjegjësi të plotë për dëmet e shkaktuara.

2.4 Në rastin kur karta ka skaduar, është dëmtuar, shpallur e pavlefshme etj. mbajtësi i kartes duhet ta dorezoje karten në Bankë dhe punonjesi pergjegjes i bankes duhet ta shkaterroje karten (ta prese në dysh) në prani të mbajtësit të kartes.

2.5 Mbjatësi i kartes merr përsipër të informojë Bankën me shkrim menjëherë, në rastin kur informacioni i dhënë në formularin e aplikimit per karte, ndryshon.

2.6 Mbjatësi i kartes merr përsipër të paguajë të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me transaksionet, përfshirë këtu tarifet e aplikuar, të kryera nga mbajtësi i kartes shtese.

2.7 Mbjatësi i kartes mund te hase pengesa gjate kryerjes se transaksioneve te cilat mund te vijne si pasoje e: vendosjes se gabuar te pinit; mungeses se fondeve ne llogarine e lidhur me karten; mungeses se linjes ne aparatit e zgjedhur per kryerjen e veprimit; mos plotesimi i ndonje prej kushteve te parametrizuar per autorizimin e transaksionit te kerkuar; gabimit ne prodhim ne lidhje me te dhenat e personalizuara te kartes; difekteve ne ATM apo POS; vendosjes gabim te CVV2 etj.

3. Kushtet e Pagesës

3.1 Karta e debitit është gjithmonë ne funksion te llogarise rrjedhëse të mbajtësit të kartes. Kjo lloj karte mund të përdoret nga mbajtësi i saj vetëm nëse ka fonde të mjaftueshme në llogari.

3.2 Mbjatësi i kartes e autorizon Bankën të debitojë llogarinë rrjedhëse të tij/saj per shumën e çdo transaksioni te kryer, pagese, komisioni apo tarife që aplikohet sipas rastit te përdorimit të kartes ne Shqipëri dhe jashtë vendit.

3.3 Nëse karta përdoret në shtete të cilat kanë në përdorim valuta te ndryshme nga Lek, mbajtësi i kartes pranon kursin e kembimit valutor dhe tarifet e aplikueshme nga MasterCard & VISA International.

4. Ankesat

4.1 Në rast të ndonjë ankese që ka të bëjë me cilësinë dhe sasinë e mallrave apo shërbimeve te blera, mbajtësi i kartes duhet ta zgjidhë këtë mosmarrëveshje me perfaqësuesin e njesise tregtare ku ka kryer transaksionin. Banka nuk eshte pergjegjese në rast të ndonjë ankese që ka të bëjë me cilësinë dhe sasinë e mallrave apo shërbimeve te blera me karte. Mbjatësi i kartes është përgjegjës për të gjithë shumën e harxhuar nga përdorimi i kartes, pavaresisht nga e drejta e tij per paraqitjen e ankesave. Mbjatësi i kartës nuk mund të anulohë një urdhër të iniciuar nëpërmjet kartës, përveç rasteve kur në urdhër nuk është përcaktuar shuma.

4.2 Mbjatësi i kartes gezon te drejten e reklamimit ne Banke per cdo debitim qe ka rrjedhur nga veprimi me karte. Ky reklamim realizohet me ane te formularit standart te reklamimit qe plotesohet dhe dorezohet prane cdo pike sherbimi te Bankes brenda nje afati 120 ditor. Per te vlersuar reklamimin e Mbjatësit te Kartes, Banka do te mbeshtetet dhe do te respektojë Rregulloren e Operimit te Visa; Guiden per Chargeback te Master; dhe Rregulloret ne fuqi te Bankes se Shqipërise.

5. Karta e humbur apo e vjedhur

5.1 Mbjatësi i kartes mban përgjegjësi ligjore në rast të ndonjë keqpërdorimi të mundshëm të kartes. Nëse karta humbet apo vidhet, mbajtësi i kartes duhet të informoje menjëherë banken ne degën më të afërt ProCredit Bank ose te telefonoje Operatoret Suport per Karta në numrat e telefonit: +355 42 2389389per te bere bllokimin e saj dhe me pas te paraqitet ne banke per te mbyllur karten. Numrat e telefonit janë në funksionim 24 orë ditë/7 ditë në javë. Bllokimi i kartes mund te behet nga vete kartembajtësi edhe nepermjet aplikacionit te bankes ne telefon. Gjithashtu mbajtësi i kartës duhet të njoftojë menjëherë Bankën në rast se karta shkatërrohet, falsifikohet, kopjohet, nëse vëren ndonjë abuzim, mashtrim me PIN-in/fjalëkalimin e tij, ose CVV2 që bën të mundur aksesin e personave të tretë në llogarinë e tij; transaksioni është kryer pa marrë miratimin nga mbajtësi i kartes; vëren ndonjë gabim apo mospërputhje në llogarinë e kartës. Në rast të vjedhjes apo humbjes së

kartes, mbajtësi i kartes mban përgjegjësi për shpërdorime të mundshme të ndodhura përpara se të ketë informuar Bankën.

5.2 Nëse karta gjendet pasi të jetë deklaruar si e humbur apo e vjedhur, ajo nuk mund të përdoret. Mbajtësi i kartes duhet të informojë menjëherë Bankën dhe ta kthejë kartën në bankë për shkatërrim.

5.3 Në rastin kur mbajtësi i kartes e informon bankën për humbje apo vjedhje të kartes, Banka duhet të lëshojë një karte të re. Shpenzimet për zëvendësimin e kartes do të debitohen nga llogaria rrjedhëse e mbajtësit të kartes.

6. Perfundimi i afatit të Kartes dhe Kontrates

6.1 Pas datës së perfundimit të afatit të kartes, karta bëhet e pavlefshme dhe nuk duhet të përdoret.

6.2 Karta e skaduar duhet të kthehet në bankë në momentin e marrjes të kartes së re.

7. Anullimi i Kartes

7.1 Banka mund të revokojë të drejtën e mbajtësit të kartes për përdorim të kartes në çdo kohë. Nëse mbajtësi kryesor i kartes dëshiron të anulojë përdorimin e kartes shtese, ai/ajo duhet ta informojë bankën menjëherë.

7.2 Perfaqësuesit e njesive të tregtimit mund ta konfiskojnë kartën, ta shkatërrin (presin atë në dysh) në prani të mbajtësit të kartes dhe ta dorëzojnë në banke, në rast keqpërdorimi nga persona të paautorizuar që s'jane mbajtës të kartes, apo kur ata kanë marrë udhëzime të tilla nga banka.

8. Tarifat Bankare

8.1 Tarifa për aplikimin/rinovimin automatik të kartes (nese ka) paguhet menjëherë në momentin e lëshimit të saj. Banka i përcakton tarifën sipas listës së cmimeve që gjendet i publikuar në faqen zyrtare të bankes dhe që i bashkangjitet këtij dokumenti dhe mund t'i ndryshojë ato. Komisioni për ndërrimin e kodit të kartes paguhet menjëherë në momentin e ndërrimit të kodit. Për ndryshimet në tarifa e komisione, mbajtësi i kartes do të njoftohet rregullisht nga banka. Nëse klienti nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë e lidhur me kartën në momentin e aplikimit/ rinovimit automatik të kartes komisioni do të perllogaritet si detyrim i klientit.

9. Kufizimet/Ndërprerja/Bllokimi i Kartes

9.1 Banka rezervon të drejtën të bllokojë kartën në çdo kohë dhe pa paralajmërim në rast shkelje të kushteve të kesaj kontrate nga ana e mbajtësit të kartes.

9.2 Karta mbetet pronë e Bankës, e cila mundet, sipas vendimit të saj, të anulohet vlefshmërinë e kartes ose ta bllokojë atë në çdo kohë. Mbajtësi i kartes, në këtë rast, duhet të ndërpresë menjëherë përdorimin e kartes dhe ta kthejë atë në bankë. Mbajtësi i kartes mban përgjegjësi ligjore nëse vazhdon ta përdorë edhe më tej kartën.

9.3 Kjo kontrate është e vlefshme për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të ndërpritet në çdo kohë nga secila palë me një njoftim me shkrim Banka mund ta ndërpresë kontratën menjëherë në rastet e vecanta të parashikuara në këtë kontratë.

9.4 Mbajtësi kryesor i kartes në rast njoftimi për ndërprerjen e kontrates duhet të kthejë kartën në Bankë së bashku me kartat e tjera shtese (në rast se ka) për të cilat ai mban përgjegjësi.

9.5 Në secilin rast, zgjidhja e kontrates nuk duhet të ndikojë në detyrimet e mbetura dhe të papërbushura të mbajtësit të kartes sipas kesaj kontrate.

9.6 Banka rezervon të drejtën që në rast dyshimi të bazuar në humbjen, grabitjen, keqpërdorimin etj. të kartës të kryejë bllokimin e saj deri në qartësimin e fakteve apo të ngjarjes së dyshuar si dhe të njoftojë menjëherë mbajtësin e saj.

10. Ligji i aplikueshem dhe Juridiksioni Gjyqësor

10.1 Kontrata për lëshimin, rinovim automatik dhe përdorimin e kartes së Debitit përbehet nga Rregullat e Biznesit, Formularin e Aplikimit dhe Kushtet e Përgjithshme. Banka rezervon të drejtën të ndryshojë Rregullat e Biznesit dhe Kushtet e Përgjithshme dhe të njoftojë mbajtësin e kartes për keto ndryshime. Nëse mbajtësi i kartes nuk është dakord me Rregullat e Biznesit të ndryshuara, brenda një periudhe 30 ditore nga marrja dijeni për keto ndryshime, mund të ndërpresë kontratën e kartes së debitit duke njoftuar bankën dhe ta kthejë kartën në bankë për shkatërrim. Nëse nuk vepron në këtë mënyrë, do të kuptohet se i ka pranuar kushtet e ndryshuara. Nëse mbajtësi i kartes ndërpret marrëveshjen, në momentin kur aplikimi i tij është miratuar dhe ka pranuar e marrë kartën, duhet të paguajë Bankën për shpenzimet që kanë ardhur si rrjedhojë e procesit të lëshimit të kartes.

10.2 Banka merr përsipër përgjegjësinë që të gjitha të dhënat e mbajtësit të kartes do mbahen në mënyrë konfidenciale dhe në përputhshmëri me legjislacionin Shqiptar në fuqi. Mbajtësi i kartes duhet të lajmërojë menjëherë bankën në rast të ndërrimit të adresës, apo ndryshimeve në informacionin e deklaruar në formularin e aplikimit, që mund të kenë një efekt negativ në përdorimin e rregullt të Kartes, duke u paraqitur vetë personalisht në degët e Bankes.

Të gjitha shumtat, tarifën dhe komisionet në lidhje me përdorimin e kartes do të mbledhen nga banka në përputhje me Listën e Çmimeve të bankës për tarifën e shërbimit si dhe me rregullat e MasterCard & VISA International. Çdo përdorim i kartes që nuk është në përputhje me: Kushtet e Përgjithshme të Biznesit;

Rregulloren e Operimit të Visa dhe Guiden për Chargeback të Master; Rregulloret në fuqi të Bankes së Shqipërisë.

do të shkaktojë zgjidhjen e menjëhershme të kontrates dhe mbylljen e kartes, dhe Banka ka të drejtën të ndermarre të gjitha hapat ligjore të nevojshme kundër mbajtësit të kartes.

Kjo Kontratë është hartuar në mbështetje të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Gjykatë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykatë e Rrethit të Tiranës.

11. Përkthimet

11.1 Mbajtësi i kartes mund të marrë një përkthim të rregullave mbi përdorimin e kesaj karte edhe në gjuhën angleze. Sidoqoftë, në rast të ndonjë mosperputhjeje ndërmjet tekstit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze, do të ketë epersi versioni në gjuhën shqipe.

12. NJOFTIMET 12.1 Banka me nënshkrimin e kesaj marrëveshjeje për çdo ndryshim të kushteve të saj (marrëveshjes) para se ndryshimet të bëhen efektive do të njoftojë me shkrim Klientin me mjete elektronike në adresën elektronike ose në numrin e celularit të dhënë me siper nga Klienti dhe në mungesë të tyre me poste në adresën postare të dhënë me siper nga Klienti. Klienti është i detyruar t'i japë Bankës numrin e celularit dhe adresat e sakta e të plota që në momentin e parë të aplikimit dhe edhe sa herë që ka ndryshime të tyre. Në rast se klienti nuk i jep bankës keto të dhëna apo pas ndërrimit të tyre nuk njofton Bankën dhe nuk i perditeson ato në sistemin bankar, atëherë Banka nuk mban përgjegjësi dhe nuk ka asnjë detyrim për të demshperblyer në lidhje me demin që mund të shkaktohet klientit nepermjet këtij produkti (karte debiti) nga palë të treta me apo pa dijeninë e klientit. Çdo ndryshim do të bëhet i njohur edhe në faqen zyrtare të internetit të Bankës si dhe në ambientet publike të Bankës. Në rast se nga Klienti nuk ka vërejtje në lidhje me këto ndryshime, me kalimin e periudhës 10 ditore ato bëhen efektive

Vendi, Data
(Place, Date)

Emër, Mbiemër, Nënshkrimi i Përfaqësuesit ligjor/Person i Autorizuar
(Name, Surname, Signature, Legal Representative/ Authorized person)